

MUSLIMANI I VOGËL

TEKSTE QË PËRFSHIJNË PARIMET E
ISLAMIT DHE MORALIT
PËR FËMIJËT MUSLIMAN

PREZANTUAR NGA NJË GRUP PROFESORË NGA ALGJERIA
DREJTUAR NGA DEPARTAMENTI SHKENCOR TË INSTITUTIT SUNEH NËN
MBIKËQYRJEN E SHEJH HEJTHEM SERHAN.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Kapitulli i parë

1

Besimi im


Unë jam musliman



ALLAHU ËSHTË ZOTI IM.



**MUHAMEDI - PAQJA DHE BEKIMI I ZOTIT
QOFSHIN MBI TË - ËSHTË PROFETI IM.**



ISLAMI ËSHTË FEJA IME.

UNË E DUA ZOTIN E MADHËRISHËM.

***Sepse Ai është Zoti i botëve, Mëshiruesi,
Mëshirëploti, Sunduesi i Ditës së Gjykimit.**

***Unë e dua Zotin tim sepse Ai më krijoi mua, më
furnizoi dhe më bëri mua musliman.**



Surja el-Fatiha

Allahu thotë:

“Bismi lahi Er-rrahmani Er-rrahim.”

“Me emrin e të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit”

“El-hamdu lil-lahi Rabbil-alemin”¹

“E gjithë lavdia i takon All-llahut, Zotit të krijesave”

“Er-Rahmanir-Rahim”²

“Të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit”

“Maliki jeumid-din”³

“Sunduesit të Ditës së Gjykimit.”

“Ijjake neabudu ue ijjake neste'in”⁴

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Prej Teje ndihmë
kërkojmë.”

“Ihdinas-siratal-mustekim”⁵

“Udhëzona në rrugën e drejtë!”

“Siratal-ledhine en'ante 'alejhim”⁶

“Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi”

“Gajril-megdubi alejhim ue led-dal-lin”⁷

“...e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin

Tënd as në të atyre që janë të humbur!”

El-Fatiha 1-7

bekimet e Zotit qofshin mbi të -:
Sepse Zoti e dërgoi atë tek ne,
kështu që ai na bëri të njohim Zotin,
dhe na mësoi Kur'anin.
Dhe për shkak se ai - paqja dhe
bekimet e Zotit qofshin mbi të -
është i mëshirshëm dhe i butë,
morali i tij është i lartë dhe cilësitë e
tij janë të bukura.

Allahu i ka cilësuar duke thënë për të:
« Se ti je me virtyte madhore »

Al-kalam: 4

DHE KA THËNË:

« " Ai është i butë e i
mëshirshëm me
besimtarët". »

ET-TEUBE: 128

Dhe ka thënë gjithashtu:

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

**ME EMBIN E ALLAHUT, TË GJITHMËSHIRSHMIT,
MËSHIRËPLOTIT!**

Inna e'atajnakel-keuther.¹

**1. Vërtet, Ne të kemi dhënë ty
(Muhamed) shumë të mira,**

Fe sal-li li rabbike uenhar.²

**2. Andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd
dhe ther kurban!**

Inne shani'eke huvel ebter.³

**3. Sigurisht, ai që të urren ty, vetë
është fatprerë.**

SURE EL-KEVTHER

Dhe unë e dua fenë time Islame

Sepse është feja e vetme e vërtetë që Zoti e
ka pranuar për ne dhe me të ka ardhur
Profeti ynë, alejhi selam.
Dhe kushdo që i përmbahet atij do të hyjë
në Xhenet, e kush e braktis atë do të hyjë
në Xhehenem.

Allahu i Madhërishëm thotë:

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Uel-asr.
Betohem në kohën! **1**

Innel insane lefi husr. **2**
Me të vërtetë, njeriu është në humbje,

lel-ledhine amenu ue'amilus-salihati **3**
ue teuasau bil-hakki ue teuasau bi-sabr.
përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra
të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të
vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit
durimin.

El-Asr 1-3

Shtyllat e Islamit janë pesë:

5

- Dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Zotit i Cili meriton të adhurohet me të drejtë dhe se Muhamedi është i Dërguari i Zotit.

- Falja e namazit.

- Dhënia e zekatit.

- Agjërimi i Ramazanit.

- Pelegrinazhi në Shtëpinë e Shenjtë të Zotit (Haxhi)

1

Shtyllat e besimit Islam janë gjashtë:

6

- Besimi në Zot.

- Besimi në Engjëjt.

- Besimi në Librat.

- Besimi në të Dërguarit.

- Besim në Ditën e Fundit.

- Besimi në paracaktimin, se të mirat dhe të këqijat janë prej Tij.

*UNË DUA ÇDO GJË QË E DO ZOTI DHE I
DËRGUARI I TIJ.*



*UNË E URREJ ÇDO GJË QË
ALLAHU DHE I DËRGUARI I
TIJ E URREJNË.*



Kapitulli i dytë

2

Namazi im


Zoti na krijoi që ta
adhurojmë vetëm Atë, Ai
nuk ka shok, kështu që ne
nuk adhurojmë askënd
përveç Tij dhe nuk i lutemi
askujt tjetër përveç Tij,
lavidërimi i qoftë Atij

Adhurimi më i madh është:
Namazi



5

Namazet janë pesë:



Namazi i sabahut

2

Unë fal dy rekate

Namazi i drekës

4

Unë fal katër rekate

Namazi i ikindisë

4

Unë fal katër rekate

Namazi i akshamit

3

Unë fal tre rekate

Namazi i jacisë

4

Unë fal katër rekate



- Jam i kujdesshëm me Namazet i fal në kohë dhe i fal me përlësi.

Marr abdes para se të falem, dhe kurrë nuk falem pa abdes.



Kapitulli i tretë

3

Morali im

Zoti i do: Sjelljet e mira dhe urren sjelljet e këqija.
Dhe Profeti, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi
të, erdhi për të përsosur moralin e mirë.

Unë duhet të kem sjellje të mira:

Të tilla si: Ndershmëria, besnikëria,
mirënjohja , guximi, bujaria, të flas mirë, të
respektoj mësuesin dhe nderoj të madhin.

Unë largohem nga sjelljet e këqija:

Të tilla si: Gënjeshtria, tradhtia, dobësia,
koprracia, fjalët e këqija dhe
mosrespektimi.


Profeti, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë

((Më i afërti prej jush me mua në Ditën
e Kiametit do të jenë ata që kanë
moralin më të mirë në këtë botë)).




PËRFUNDIMI

**Dija është dritë, dhe injoranca është errësirë,
Kështu që unë përpiqem të kërkoj dituri dhe përpiqem me
të gjitha mundësitë për ta fituar atë, në mënyrë që Zoti
im të jetë i kënaqur me mua dhe të më futë në Xhenet.
Përmendja e Allahut është një kështjellë për muslimanin:
Kështu që unë kujdesem për lutjet e mëngjesit dhe të
mbrëmjes, duke përfshirë: Leximin e Ajetit El-Kursi,
suren El-Ikhlâs dhe suren Felek dhe Nas.
Lutja është çelësi i suksesit dhe lumturisë.
Kështu që unë i lutem Zotit tim shumë, në çdo kohë: në
sexhde, pas ezanit dhe gjatë natës.**



Dhe nga lutjet:
O Allah, më udhëzo dhe më drejto.
O Allah, më shto diturinë.
O Allah, më fal mua dhe prindërit e mi dhe
mëshiroji ata.
O Allah, më jep të mira në këtë botë dhe të
mira në ahiret dhe më ruaj nga dënimi i
zjarrit.

Së fundmi Falënderimi i
takon Allahut



**Libri Muslimani i vogël: Një libër në
gjuhën Shipe, drejtuar nga faqja e
internetit "Luaj dhe Mëso", e cila
mbikëqyret nga Sheikh Dr. Hejthem
Serhan, tekst që përfshin parimet e
Islamit dhe moralin për fëmijën
musliman. Vjen me një konstrukt të
bukur dhe emocionues, libri është
argëtues, i bukur dhe tërheqës, gjë që e
bën këtë libër të këndshëm.**